

Vleftësimi i të nxënit të mëparshëm

Bashkohuni me komunitetin e EPALE me më shumë se 24 000 specialistë të të nxënit për të rritur për të vlerësuar, komentuar dhe kontribuar!

Të dashur kolegë të EPALE,



Fokusi ynë tematik gjatë muajit prill ishte vleftësimi i të nxënit të mëparshëm. Ne kemi marrë një numër të madh kontributesh nga ekipet kombëtare të EPALE dhe nga komuniteti i EPALE. Hidhni një sy faqes tonë tematike **Vleftësimi i të nxënit të mëparshëm** për artikuj interesantë, burime të dobishme dhe materiale të tjera në lidhje me këtë temë.

Lexoni përmbledhjen e Koordinatorit Tematik David Mallows në lidhje me fokusin e EPALE gjatë muajit prill.

Postime në formë blogu

Vleftësimi i të nxënit jo-formal dhe informal: origjina dhe sfidat e ardhshme

George K. Zarifis, Asistent Profesor për Arsimin e Vazhdueshëm në Universitetin Aristotle të Selanikut, analizon origjinën e ideve për vleftësimin, mënyrën e formëzimit të tyre në politika konkrete në Europë dhe sfidat e ardhshme.

Vleftësimi i të rriturve me kualifikim të ulët: 11 rekomandime

Koordinatorja Tematike e EPALE për Mbështetjen e Nxënësve, Gina Ebner prezantoi mesazhet kyçe dhe momentet kryesore nga një seminar për vleftësimin e të rriturve me kualifikim të ulët.

Vleftësimi dhe personat me aftësi të kufizuara –Si ta bëjmë realitet

EPALE bisedoi me Dora Redruello nga Shoqata e Paralizës Cerebrale të Coimbra. Znj. Redruello dhe ekipi i saj kanë lëshuar mbi 250 certifikata vleftësimi për personat me aftësi të kufizuara.

Lajme nga mbarë Europa



Muaji prill ishte një muaj i ngjeshur me aktivitete për sektorin e të nxënit për të rriturit në Europë:

- [Hungaria ka organizuar Natën e Profesioneve për të dytin vit](#) – një event ku të rriturit mund të takojnë ofrues të ndryshëm të formimit profesional dhe të gjejnë një rrugë të re për karrierën e tyre (në gjuhën hungareze).
- Ndërkohë në Sllovaki [qeveria ka shpallur reformën në arsim](#) duke i vënë një theks më të fortë të nxënimit gjatë gjithë jetës (në gjuhën sllovake).
- Në Slloveni [Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Sporteve ka nisur një konsultim publik](#) në lidhje me projektin e Strategjisë Kombëtare për Shkrim-Këndimin (në gjuhën sllovene).

Mos harroni të merrni pjesë në anketën e Erasmus+ për impaktin e programeve për lëvizshmërinë dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në sektorin e arsimit, formimit, rinisë dhe sportit.

Bashkohuni tani!

Mos harroni të regjistroheni në EPALE për të qenë në gjendje që të ndani mendimet tuaja në këto postime. [Bashkohuni tani](#) dhe bëhuni pjesë e komunitetit të përbërë nga më shumë se 24 000 specialistë të të nxënimit për të rriturit.